



**Përmbledhje e Aktivitetit të Misionit të RSH-së
në Këshillin e Sigurimit
(Java 2)**

10 - 14 janar 2022

10 janar 2022

Koreja e Veriut: Këshilli I Sigurimit zhvilloi konsultime urgjente pas testit balistik nga RP e Koresë së Veriut, me kërkesën e bërë nga SHBA, **Shqipëria**, Britania e Madhe, Franca dhe Irlanda për të mbajtur një takim urgjent konsultimesh të Këshillit të Sigurimit në vijim dhe në dënimin të testit balistik të datës 5 janar 2022, kryer nga Republika Popullore Demokratike e Koresë.

Në një deklaratë të përbashkët të këtyre pesë vendeve, përfshirë edhe Japoninë, të publikuar para fillimit të konsultime të mbyllura të Këshillit të Sigurimit mbi ngjarjen, **Shqipëria** dhe vendet e tjera theksuan se testi i 5 janarit ishte një shkelje e qartë dhe e përsëritur e shumë rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe përbën një kërcënim serioz të paqes dhe sigurisë në botë në tërësi dhe për gadishullin Korean në veçanti.

Shënim: Mbajtja e këtyre konsultimeve pati jehonë në media dhe përfshirja e Shqipërisë në grupin e vendeve që kërkuan mbajtjen e konsultimeve pati pasqyrim të gjerë në rrjetet sociale dhe në media.

Afrika Veriore dhe rajoni i Sahelit – UNOËAS: Këshilli i Sigurimit mbajti takimin gjashtëmuor mbi situatën në rajonin e Afrikës Perëndimore dhe rajonin e Sahelit. Përfaqësues të OKB-së si dhe një përfaqësuese e shoqërisë civile, informuan Këshillin mbi zhvillimet politike, situatën e sigurisë, përfshirë shqetësimet për ritmin e ngadaltë të vendosjes së autoritetit civil dhe rikthimin e demokracisë, parë nga këndvështrimet respektive.

Ambasadori Hoxha përshëndeti punën e UNOWAS dhe organizatatve rajonale për rolin vendimtar në promovimin e paqes dhe stabilitetit në rajon. Situata e sigurisë në rajonin e Sahelit mbetet jashtëzakonisht shqetësuese dhe, për shkak të pozicionit të tij gjeografik, kjo ka ndikim në të gjithë rajonin, kontinentin dhe më gjerë, duke lidhur Afrikën Sub-Sahariane me pellgun e Mesdheut. “Çështjet e paqes dhe sigurisë duhet të trajtohen me një qasje shumëdimensionale dhe gjithëpërfshirëse duke përfshirë këtu dimensionet e zhvillimit, politikës, sigurisë, drejtësisë dhe të

drejtave të njeriut.” Në përputhje me përparësitë e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit, Ambasadori u shpreh se, sot më shumë se kurrë, duhet investuar tek gratë, si figura qendrore në komunitetet lokale dhe nxitëse të bashkimit në shoqëri. Të gjitha vendet anëtare të Këshillit vlerësuan punën e UNOËAS dhe rolin e saj në parandalimin e konflikteve dhe rëndësinë e një qasjeje holistike në trajtimin e situatës së sigurisë në rajon.

11 janar 2022

Situata në Mali: Në datën 11 janar 2022 Këshilli i Sigurimit mbajti takimin periodik tre mujor mbi situatën në Mali.

Situata e sigurisë në Mali në tërësi vazhdon të përkeqësohet, përfshirë në aspektin humanitar. Vendet e Këshillit, përfshirë **Shqipërinë**, përsëritën mbështetjen e tyre të fortë për përpjekjet ndërmjetësuese të Komunitetit Ekonomik të Shteteve të Afrikës Perëndimore (ECOWAS) në Mali dhe u bënë thirrje autoriteteve kalimtare që të paraqesin me sa më parë një plan kohor për zgjedhjet në mënyrë që të arrihet kthimi i shpejtë në rendin kushtetues.

Ambasadori Hoxha shprehu shqetësimin e thellë për shtimin e sulmeve ndaj civilëve dhe paqeruajtësve dhe për nevojën urgjente për vendosjen e prezencës shtetërore në të gjithë vendin, dhe në mënyrë të vecantë, lidhur me njoftimet për rekrutimin e mercenarëve në Mali. Vendi ynë shprehu shqetësim të vecantë lidhur me njoftimet për rekrutimin e mercenarëve në Mali. “Siç e kemi parë në skenarë të tjerë, kjo mund të minojë stabilitetin edhe ashtu jashtëzakonisht të brishtë, të çojë në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe të ketë pasoja të rënda edhe për marrëdhëniet e të gjithë sistemit të OKB-së me Bamako-n”, theksoi Hoxha. “Mali ka nevojë për vendime të shëndosha, veprime të përgjegjshme dhe jo mercenarë të papërgjegjshëm” u shpreh ai.

Shënim: Ka një mendim të kondoliduar nder vendet njëmëndëse se mercenaret e shoqërisë private ruse Wagner janë të sponsorizuar dhe kanë mbështetjen e qeverisë Ruse. Disa qindara janë dislokuar aktualisht në Mali. Qeveria atje i konsideron si “këshiltarë dhe trajnues”. Franca, e cila është angazhuar ushtarakisht në vend, dhe e sheh po humb terren në hapësirat historikisht nën ndikimin e saj, është vecanërisht e interesuar për këtë çështje. Angazhimi ynë aktiv por edhe në çështje të tjera të Afrikës mirëpritet nga BE-se dhe vecanërisht, Franca.

12 janar 2022

Jemen: Këshilli i Sigurimit u mbledh për të analizuar zhvillimet më të fundit mbi situatën në Jemen. Zhvillimet e fundit tregojnë një përkeqësim të mëtejshëm të gjendjes në Jemen, sidomos me përshkallëzimin e luftës gjatë muajit të fundit, pasojat e të cilit vënë në rrezik të drejtpërdrejtë ekonominë e vendit, infrastrukturen civile, si dhe civilët e pafajshëm, sidomos gratë dhe fëmijët. Dhuna ndaj grave, uria dhe sëmundjet vazhdojnë të marrin jetë njerëzish.

Ambasadori Hoxha shprehu mbështetjen e plotë të Shqipërisë për punën e të Dërguarit të Posaçëm, dëshirën për të parë sa më shpejt rezultate të prekshme duke u dhënë fund luftimeve dhe angazhimit në një proces politik të strukturuar, të qendrueshëm dhe rezultativ. Ai theksoi rëndësinë

që të sigurohet pjesëmarrje, thelbësore, të plotë dhe e barabartë e grave në procesin politik dhe zgjidhjet që dalin prej tij. Shqipëria dënoi sulmet e milicëve Huthi në Arabinë Saudite, kërkoi respektimin e ligjit ndërkombëtar dhe dënoi po ashtu aktin e piraterisë nga Huthi ndaj një anijeje me flamur të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe kërkoi lirim të menjehershëm.

Shënim: Shqipëria do të drejtojë dhe komitetin e sanksioneve për Jemenin cka paraqet një interes të bvecantë duke mbajtur parasysht aktorët e përfshirë në këtë vend.

Situata në Sudan: Me kërkesë të SHBA-ve, Shqipërisë, Francës, Norvegjisë, Irlandës dhe Meksikës, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara zhvilloi konsultime urgjente lidhur me zhvillimet e fundit në Sudan, pas dorëheqjes së Kryeministrit Abdalla Hamdok.

Dorëheqja e Hamdok më 2 janar solli një vakum politik duke e lënë qeverisjen e plotë të vendit krerëve ushtarakë të cilët më tetor 2021 e kishin marrë atë përmes forcës ushtarake. Marrëveshja jetëshkurtër e arritur mes palëve më 21 nëntor, krijoi shpresën e vijimit të tranzicionit demokratik të nisur më 2019.

Ambasadori Hoxha u bëri thirrje të gjitha palëve të interesuara në Sudan që të ulen në tavoline për të shpëtuar përparimin e bërë deri tani, për të lënë mënjane interesat e ngushta personale dhe për t'u angazhuar në një dialog kombëtar kuptimplotë, me lehtësimin e komunitetit ndërkombëtar dhe përfshirjen e të gjitha grupeve, përfshirë gratë dhe të rinjtë, të cilët kanë një rol kyç në konsolidimin e demokracisë.

Historia ka treguar, threksoi ai, se për të ndërtuar një të ardhme të përbashkët në drejtësi dhe barazi për të gjithë, përballja me të shkuarën duhet bërë seriozisht dhe me transparencë sado komplekse dhe delikate që të jenë çështjet.

Situata në Qipro: Këshilli I Sigurimit u takua me Vendet Kontribuese me Trupa në Misionin Paqeruajtës të OKB-së në Qipro-UNFICYP.

Në takim, ZvPërfaqësuesja e Përhershme, Znj. Dautllari, vlerësoi kontributin e UNFICYP në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në Qipro. Theksoi rëndësinë e vazhdimin të dialogut politik, si e vetmja mënyrë për arritjen e një zgjidhje të qëndrueshme dhe realiste të çështjes. Gjithashtu, vuri në dukje rolin e rëndësishëm të grave në Misionin Paqeruajtës të OKB-së dhe nevojën e angazhimit të mëtejshëm të tyre.

Shënim: kjo do të jetë një çështje për të cilës do të duhet të tregojmë vëmendje të shtuar duke mbajtur parasysht marrëdhëniet tona me BE, Turqinë dhe Greqinë. Turqia kërkoi që kjo çështje të trajtohet sa më pak në Këshillin e Sigurimit, ndërkohë që Qipro kërkoi që të mbahet në agjendë 2 herë në vit.

13 janar 2022

Norvegjia, në cilësinë e Presidentit të Këshillit për muajin janar 2022, organizoi “the Presidential Retreat – Oslo Process” – një takim informal të 15 anëtarëve të Këshillit, jashtë OKB-se dhe

qytetit.

Gjatë drekës mujore të Këshillit me Sekretarin e Përgjithshëm, e që ishte pjesë e programit, u diskutua lidhur me diplomacinë parandaluese dhe rolin e Këshillit të Sigurimit në këtë aspekt (*shënim: Këshilli i Sigurimit kritikohet rëndom dhe hapur – e me të drejtë - për mangesinë e dukshme që ka në parandalimin e konflikteve për shkak të ngadalësisë në veprim si rezultat i përplasjes së interesave të vendeve anëtare të Përhershme*)

Gjatë “retreat” u diskutua po ashtu – me pjesëmarrës të zgjedhur - lidhur me procesin e paqes në Kolumbi si dhe mbi diplomacinë “pas perdeve” të Norvegjisë dhe rolin e suksesshëm që ka luajtur në një numër procesesh të vështirë (Oslo Accords on the Middle East).

Darka iu kushtuar analizës së gjithashme të situatës në Afganistan e për cka u zhvillua një diskutim i njëmendtë e tejet informues. Lyse Doucet, një nga gazetaret më të njohura të BBC, senior world correspondent dhe dëshmitare e thauje të gjitha krizave dhe ngjarjeve më të rëndësishme në botë në 30 vitet e fundit, e cila moderoi debatin mbi Afganistanin, përmendi disa herë “rolin e vecantë të Shqipërisë dhe të KM Rama, shembullin e dhënë jo vetëm për pritjen por edhe për trajtimin e refugjatëve afghan”.

Shënim: retreats janë një ushtrim i përhershëm e periodic I Këshillit të Sigurimit me iniciativën e vendeve anëtare. Ato shërbejnë për të diskutuar më një mjedis e format më informal për çështje të rëndësishme si dhe për të ndërtuar marrëdhënie pune sa më të shkrifta mes përfaqësuesve. Vendi organizator merr gjithnjë kreditin e menduar duke pasur parasysh se aktivitetet të tilla bëhen pjesën e gjurmëlënies në shërbimin në Këshill. Misioni ka propozuar një aktivitet të ngjashëm, për në muajin shkurt 2022 në Tiranë, në një nga tematikat që janë përparësi për ne, Metodot e Punës së Këshillit.

14 janar 2022

Situata në Jemen: Këshilli I sigurimit miratoi një deklaratë që dënon rrembimin dhe ndalimin e një anije me flamurin e Emirateve të Bashkuara Arabe. Këshilli dënoi incidentët e ndodhura në brigjet e Jemenit të cilat shkaktojnë një risk të madh për sigurinë lundruese në rajon. Shqipëria ju bashkua iniciativës që në krye të herës.

Organet Ndhmëse të Këshillit: Edhe gjatë javës së dytë në Këshill, Misioni ka qenë vecanërisht e në mënyrë të pandërprerë i angazhuar, në cilësi të dyfishtë (edhe si vend i interesuar edhe në kapacitetin e koordinatorit të E10) me negociatat për finalizimin e ndarjes së kryesimit të Organeve Ndhmëse të Këshillit të Sigurimit. Pas shumë përpjekjesh, procesi u finalizua në darkën e ditës së mërkurës.

Në përputhje me angazhimin e marë publikisht për të qenë sa më aktiv në ushtrimin e mandatit, Shqipëria do të kryesoje 4 komitete: ato për Libanin, Irakun, Jemëin si dhe do të marrë kryesinë e grupit të punës mbi Metodot e Punës së Këshillit të Sigurimit.

Lidhur me këtë të fundit, prej muajsh diskutimet ishin të bllokuara nga pozicionimi kryenec i Brazilit, i cili gjithashtu kërkon kryesimin e këtij Grupi Pune edhe përpo ofertave të ndryshme që iu bënë Brazilit nga vendi ynë për bashkëpunim të ngushtë në këtë kuadër. Duke refuzuar ofertat, përfundimisht Brazili refuzoi kryesimin e cdo momiteti tjetër, një pozicionim ekstrem dhe jo I denjë, pasi në këtë mënyrë ua lë gjithë ngarkesën që I takonte, vendeve të tjera përfshirë Shqipërinë.

Të gjitha vendet e Këshillit kanë vlerësuar lart pozicionin bashkëpunues të Shqipërisë në raport me Brazilin ashtu si dhe në tërësi për zgjidhen përfundimtare të problemit.

Në këtë proces, Shqipëria gëzoi në cdo hap, mbështetjen e të 5 vendeve të Përhershme (P5).

#